

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava"- SH.A. Gjilan, i emëruar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.09/67 të dt. 09.03.2022, gjatë mbledhjes së gjashtë të rregullt të mbajtur më datë 10.11.2023, duke u bazuar në kompetencat sipas dispozitave ligjore të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, neni 21 që përcakton kompetencën e KA –së , nxjerrë këtë:

V E N D I M

I.z. Artan Hajdini emërohet për pozitën Zyrtar për Auditim të Brendshëm në KRU "Hidromorava"-SH.A. Gjilan.

II. I emëruari sipas pikës I. të këtij vendimi do të filloj punën me efekt nga data 13.11.2023 ku do të lidhet kontrata e punësimit me përshkrimin e mardhënies së punës , detyrave dhe përgjegjësiive për këtë pozitë.

A r s y e t i m

Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava"-sha Gjilan, ka zhvilluar procedurat e rekrutimit sipas konkursit publik me nr. referencës 1324 i publikuar me datë 01.09.2023 për pozitën Zyrtar/e për Auditim të Brendshëm në KRU "Hidromorava"-SH.A. Gjilan.

Komisioni i Auditimit ka përfunduar me sukses procedurën e rekrutimit dhe vlerësimit dhe me vendimin nr. 1969 të dt. 19.10.2023 ka përzgjedhur kandidatin më të sukseshëm z.Artan Hajdini për pozitën zyrtar për Auditim të Brendshëm në KRU" Hidromorava"-SH.A. Gjilan.

Me këtë vendim është përcaktuar edhe e drejta e ankesës nga kandidatët e pakënaqur me këtë proces.

Pas përfundimit të periudhës së ankesave , janë krijuar kushtet ligjore duke i dhënë të drejtë kandidatit të përzgjedhur emërimin në pozitën Zyrtar për Auditim të Brendshëm dhe lidhjen e kontratës së punës me përshkrimin e detyrave të punës.

Prandaj, Komisioni i Auditimit pas krijimit të kushteve ligjore dhe përmbylljes me sukses të procesit të rekrutimit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimit në Gjykatën Themelore në Gjilan.



Komisioni i Auditimit
Kryesuesja

(znj. Ferdane Tahiri Sylejmani)

Gjilan,
Datë: 10.11.2023